originale e vendimit për dhënien e masës disiplinore, si dhe kopje e raportit përfundimtar apo të dokumenteve të tjera mbështetëse nëse nuk janë siguruar më parë. 3. Një kopje e vendimit për dhënien e masës disiplinore, e nënshkruar nga punonjësi i ndëshkuar, i dërgohet Zyrës së Personelit, e cila pas përfundimit të afatit të ankesës ose përfundimit të procedurave të ankesës e vendos atë në dosjen personale të punonjësit. Në rast se pas procedurave të ankesës masa e dhënë anulohet, dokumentacioni përkatës i procedurës disiplinore arkivohet. 4. Kur punonjësi i ndëshkuar refuzon për të nënshkruar për marrjen dijeni për vendimin për dhënien e masës disiplinore, punonjësi që bën komunikimin e masës në prani të një punonjësi tjetër të zgjedhur prej tij, vendos shënimin refuzon nënshkrimin.	original copy of the decision for issuing a disciplinary measure, and the copy of the final report or other supporting documents if they are not ensured previously. 3. A copy of the decision for issuing disciplinary measure, signed by the punished employee, is submitted to the office of the personnel, which after the finishing term of the complaint or termination of the procedures for complaints, puts it in the personal records of employee. If after the complaint procedures, the issued measure is annulled, the appropriate documentation for disciplinary procedure is archived. 4. When the punished employee is informed for the decision for the disciplinary measure, and he refuses to sign it, the employee who communicates the disciplinary measure in the presence of the other person selected by him, puts the note refuses the signature.	kopija odluke o izricanju disciplinske mere kao i kopija konačnog izveštaja ili drugi podržavajući dokumenti, ako ranije nisu obezbeđeni. 3. Kopija odluke o izricanju disciplinske mere potpisano od strane kažnjenog radnika dostavlja se kancelariji personala koja nakon isticanja žalbenog roka ili okončanja žalbene procedure, stavlja ih u lični dosije radnika. Ukoliko se nakon žalbene procedure izricana mera anulira, odgovarajuća dokumentacija disciplinske procedure arhivira se. 4. Kada kažnjeni radnik odbija da potpiše obaveštenje o odluci za izricanje disciplinske mere, radnik koji obaveštava o meri, u prisustvu jednog radnika koga je on izabrao stavlja belešku odbija potpis.
--	---	---



KREU VI	CHAPTER VI	POGLAVLE VI
PARASHKRIMI DHE HEQJA E MASËS DISIPLINORE	OBSCOLESCENCE AND REMOVAL OF DISCIPLINARY MEASURE	ZASTARELOST I UKIDANJE DISCIPLINSKE MERE
Neni 29 Parashkrimi i shkeljes dhe i ekzekutimit të masës	Article 29 Obsclescence of a Breach and Execution of the Measure	Član 29 Zastarelost prekršaja i izvršenja mere
1. Masa disiplinore nuk mund të jepet, nëse nuk i komunikohet me shkrim punonjësit brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e vendimit, apo nëse nuk është zbuluar brenda 2 viteve nga koha e kryerjes së saj. 2. Afati 30 - ditor i komunikimit të masës mund të shtyhet nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së, për shkaqe që lidhen me procedurën e hetimit të shkeljes. Në këto raste, shtyrja e afatit bazohet në një raport me shkrim, që i dërgohet Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së çdo 30 ditë. 3. Masa disiplinore nuk ekzekutohet kur: 3.1. nga momenti i ankesës të punonjësit kanë kaluar gjashtëdhjetë (60) ditë dhe punonjësi nuk është njoftuar me shkrim për vendimin e	1. The disciplinary measure may not be issued, if it is not communicated in written form to the employee within 30 days from the date of decision or if it is not detected within 2 years from the time of its commitment. 2. The deadline of 30 - days for the communication of the measure may be postponed by the Chief Executive of the KAF for the reasons related with the investigational procedure of the breach. In these cases, the postponement of the term is based on a written report, which is sent to the KAF Chief Executive every 30 days. 3. The disciplinary measure is not executed when: 3.1. when from the moment of the complaint of employee have passed 60 days and employee is not notified in written form for the decision by the	1. Disciplinska mera ne može se izricati ako se u roku od 30. dana od odluke radnik ne dobija pismeno obaveštenje o tome ili ako delo nije otkriveno za 2 godine od izvršenja iste. 2. Rok od 30 dana obaveštenja o meri može se odložiti od strane Izvršnog načelnika KAF-a za razloge koji se nadovezuju sa istražnom procedurom prekršaja. U tim slučajevima odlaganja roka zasniva se na pismenom izveštaju koji se dostavlja Izvršnom načelniku svakih 30 dana. 3. Disciplinska mera se ne izvršava u sledećim slučajevima: 3.1. ako je od momenta žalbe radnika prošlo 60. dana a radnik nije obavešten u pismenoj formi o odluci komisije za



Komisionit të Ankesave përveç rasteve të parashikuara në nenin 38, paragrafi 10 i këtij udhëzimi; 3.2. nga momenti i ankesës të punonjësit tek eprori, kanë kaluar 10 ditë pune pa u njoftuar punonjësi për vendimin e marrë. 4. Mosrespektimi i afateve nga AKF është shkak për pushimin e procesit disiplinor. Neni 31 Shuarja e parakohshme e masës disiplinore 1. Masat disiplinore, me përjashtim të masave ulje në një detyrë më të ulët, pa të drejtë konkurrimi për ngritje në pozitën e mëparshme për 2 vjet dhe largim nga puna, mund të shuhen para afatit me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv të AKF -së, kur nga momenti i ekzekutimit të masës ka kaluar jo më pak se gjysma e afatit të shuarjes së saj. 2. Në urdhrin për shuarjen e masës disiplinore, Kryeshefi Ekzekutiv duhet të argumentojë arsyet për heqjen e saj. 3. Në rast se masa që shquhet është ulje në	Complaints Committee, except the cases foreseen in Article 38, paragraph 10 of this instructions; 3.2. from the moment of employee's complain to supervisor 10 days have passed without notifying the employee for the decision taken. 4. The disrespect of the terms by KAF is the cause for dismissal of disciplinary process. Article 31 Premature Termination of the Disciplinary Measure 1. Disciplinary measures, with the exception of measures in lowering duty; without the right to compete for promotion in prior position, for 2 years and dismissal from job, might be extinct before the term with the decision by the Chief Executive of the KAF, from the moment of execution of the measure has passed not less than half of the time of its extinction. 2. Based on the order for the cessation of disciplinary measure, the Chief Executive Officer should argument the reasons for its removal. 3. If the measure which is given is	žalbe osim predviđenih slučajeva iz člana 38, tačka 10; 3.2. od momenta žalbe radnika kod starešina prošlo je 10 radna dana bez obaveštenja radnika o donošenoj odluci. 4. Ne poštovanje rokova od strane KAF-a je razlog obustave disciplinskog procesa. Član 31 Prevremeni prestanak disciplinske mere 1. Disciplinske mere, osim kod mera postavljanje na nižim zadacima, bez prava konkurisanja na prethodnu poziciju na dve godine i isklucenja sa posla, mogu prestati pre roka odlukom Izvršnog načelnika KAF-a kad od momenta izvršenja mere prošlo ne manje od polovine roka za njen prestanak. 2. U naredbi za prekid disciplinske mere, Izvršni načelnik treba da argumentira razloge prestanka disciplinske mere. 3. Ako je mera koja prestaje „novčana
--	--	--



pagë në masën, 10% deri 20 % e pagës bazë për një muaj sasia e parave të paguara nuk i kthehet punonjësit të ndëshkuar.	reduction on salary in amount of 10% to 20% of the basic salary for one month the amount of paid money is not reimbursed to the punished employee.	kazna 10% do 20% osnovne plate za mesec dana, iznos isplaćenog novca ne vraća se kažnjenom radniku.
Neni 32 Afatet e ruajtjes dhe të shuarjes së masave disiplinore	Article 32 The Terms of Conservation and the Disciplinary Measures Extinction	Član 32 Rokovi čuvanja i prestanka disciplinske mere
1. Masat disiplinore shuhen sipas afateve të përcaktuara si më poshtë: 1.1. vërejtje verbale, pas plotësimit të periudhës 1 vjeçare; 1.2. vërejtje me shkrim, pas plotësimit të periudhës 1 vjeçare; 1.3. ulje në pagë në masën 10% deri 20 % e pages bazë për një muaj pas plotësimit të periudhës 1 vjeçare; 1.4. ulje në pozitë pa të drejtë konkurimi për ngritje në gradën e mëparshme për dy vjet, deri në çastin e rifitimit; 1.5. largim nga puna nuk shuhet dhe qëndron përgjithmonë në dosjen personale të ish-punonjësit;	1. The disciplinary measures are extinct according to the determined terms as follows: 1.1. verbal warning, after fulfilling 1 year of period; 1.2. written warning, after fulfilling 1 year of period; 1.3. reduction on salary, in amount of 10% to 20% of the basic salary for one month after fulfilling 1 year of period; 1.4. reduction in position, without the right to compete for promotion in prior rank for two years, till the moment of regaining; 1.5. the dismissal from the job does not extinguish and always stays in the personal records of the former employee.	1. Disciplinske mere prestaju na osnovi sledećih utvrđenih rokova: 1.1.usmena napomene, nakon ispunjenja perioda od 1 godine; 1.2.pismene napomene, nakon ispunjenja perioda od 1. godine; 1.3. novčana kazna 10% do 20% osnovne plate za mesec dana, nakon ispunjenja perioda od 1. godine; 1.4. postavljanje na nižu poziciju rada bez prava konkurisanja na istu pozicija za dve godine, dve godine do momenta ponovnog dobijanja prava; 1.5. isključenje sa posla ne prestaje i za stalno stoji u personalni dosije radnika;



1.6. suspendim pa pagesë nga pesë (5) ditë deri në tridhjetë (30) ditë, pas plotësimit të periudhës 1 vjeçare. 2. Masa disiplinore që jepet ndaj punonjësit të AKF-së, evidentohet në rubrikën përkatëse të dosjes së punonjësit si dhe ruhet në sistemin e bazës së të dhënave të personelit gjatë gjithë kohës së punësimit. Njëkohësisht formulari i dhënies së masës disiplinore ruhet në “xhepin” e dosjes së punonjësit deri në momentin e shuarjes së saj. 3. Në momentin e shuarjes së masës disiplinore bëhet shënimi përkatës në dosjen e punonjësit dhe në sistemin e bazës së të dhënave, si dhe hiqet formulari për dhënien e masës disiplinore nga dosja e punonjësit. 4. Të dhënat për masat disiplinore që janë dhënë ndaj personelit të AKF-së, nuk i bëhen të ditura asnjë institucioni apo strukture pa miratimin e personit ose lejen me shkrim të Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së. 5. Masa e “largimit nga puna” qëndron në dosjen personale të punonjësit dhe në sistemin e bazës së të dhënave të personelit gjatë gjithë kohës dhe pas ndërprerjes së	1.6. suspension without charge from five days to thirty days, after completing one-year period. 2. The disciplinary measure which is issued against the employee of the KAF is recorded in the relevant employee’s file and it is stored in the database system of the personnel throughout all the time of employment. At the same time form of issuing disciplinary measure is stored in the "pocket" of the employee’s file until its extinction. 3. Upon extinguishment of the disciplinary measure relevant record is done in the file of the employee and in the database system, and the form for issuing disciplinary measure is removed from the employee’s file. 4. The data on disciplinary measures that are issued toward the personnel of KAF is not given to any institution or structure without the consent of the person or written permission by Chief Executive of KAF. 5. The measure "dismissal from work" lies in the employee’s personal records and in the database system of the personnel at all times and after the termination of the	1.6. suspenzija bez nadoknade od pet do trideset dana, nakon ispunjenja perioda od 1. godine. 2. Disciplinska mera koja se izriće protiv radnima KAF-a, evidentira se u odgovarajuću rubriku radničkog dosjea u čuva se u sistemu baze podataka Personala tokom čitavog vremena zapošljavanja. Istovremeno, formular o izricanju disciplinske mere čuva se u „džepu“ dosjea radnika do momenta njenog prestanka. 3. U momentu prestanka disciplinske mere, u doije radnika i u sistemu baze podataka unosi se odgovarajuća beleška a iz dosije radnika skida se formular o izricanju disciplinske mere. 4. Podaci o disciplinskim merama koje su ozricane prema radnicima KAF-a, ne ustupaju se nijednoj instituciji ili strukturi bez usvajanja lica ili bez pismene dozvole Izvršnog načelnika KAF-a. 5. Mera „isključenje sa posla“ stoji u personalnom dosjeu radnika iu sistemu baze podataka Personala tokom vremena zaposlenja i nakon prestanka radnog
---	---	---



marrëdhënieve të punës. Kur punonjësi i AKF-së fiton të drejtën e rikthimit në detyrë me vendim të Gjykatës, vendimi i Gjykatës duhet të vendoset në dosjen e punonjësit dhe njëkohësisht ky fakt të pasqyrohet në të dhënat personale në bazën e të dhënave.	employment. When employee of KAF gains the right to return on duty with the decision of the Court, the Court's decision should be placed in the employee's file and at the same time this fact will be reflected in the personal data in the database.	odnosa. Kada radnik KAF-a stiće pravo ponovnog postavljanja na dužnosti odlukom Suda, odluka Suda treba da postavlja u radnički dosije i istovremeno ova činjenica uvodi se u ličnim podacima u bazi podataka.
KREU VII ANKESA Neni 33 E drejta në ankesë	CHAPTER VII THE COMPLAINT Article 33 The Right to Complain	POGLAVLE VII ŽALBA Član 33 Pravo na žalbu
Punonjësi ndaj të cilit merret masë disiplinore ka të drejtën e ankesës për masën e dhënë tek autoritetet e përcaktuara në nenin 34 dhe 35 të këtij udhëzimi administrativ.	The employee against whom is taken a disciplinary measure has the right to complain for the issuing measure to the authorities referred in the Article 34 and 35 of this Administrative Instruction.	Radnik prema kome se preduzima disciplinska mera, ima pravo na žalbu protiv izricane mere kod utvrđenih autoriteta članom 34 i 35. ovog pravilnika.
Neni 34 Ankesa për masat “Vërejtje verbale, dhe “Vërejtje me shkrim” 1. Kur punonjësi i AKF-së ndëshkohet me masën disiplinore “Vërejtje verbale” dhe, “Vërejtje me shkrim”, ai ka të drejtë të ankohet brenda pesë (5) ditëve nga data e marrjes në dijeni pranë strukturës së personelit, e cila e përcjell tek Kryeshefit	Article 34 Complaint for Measures "verbal warning", and "written warning" 1. When employee of KAF is punished with disciplinary measure "verbal warning" and, "written warning", he has the right to complaint within five days from the day of being aware, by the perssonel srtucture which conveys to the Chief Executive.	Član 34 Žalba na mere „Usmena opomena“ i „Pismena opomena“ 1. Kada se radnik KAF-a kažnjava disciplinskom merom „Usmena napomena“ i „pismena napomena“, on ima pravo na žalbu u roku od pet dana od dana saznanja, koju predaje u strukturi personala a zatim personal dostavlja Izvršnom načelniku.



Ekzekutiv. 2. Ankesa në të gjitha rastet bëhet me shkrim. 3. Kryeshefit Ekzekutiv duhet ta shqyrtojë dhe të marrë vendim brenda tri (3) ditëve nga marrja e ankesës. 4. Vendimi i Kryeshefit Ekzekutiv është përfundimtar. 5. Kryeshefit Ekzekutiv ose personi i autorizuar prej tij, duhet të njoftojë me shkrim punonjësën e AKF-së që është ankuar, punonjësën që ka dhënë masën, si dhe Zyren e Personelit të cilat, me marrjen e këtij vendimi, e administrojnë atë në dosjen personale të punonjësit, si dhe në sistemin elektronik të të dhënave.	2. The complaint in all cases shall be in written form. 3. The Chief Executive should review and make decision within three days upon recipient of the complaint. 4. The Chief Executive's decision is final. 5. The Chief Executive or his authorized person should notify in written form the employee of KAF who complained and the employee who has issued the measure, and the office of personnel which, on making this decision, administrate it in the employee's personal file, and in the electronic database system.	2.U svim slučajevim žalba se podnosi u pismenoj formi. 3.Izvršni načelnik treba da razmotri žalbu i donosi odluku u roku od tri dana od dana primanje iste. 4.Odluka Izvršnog načelnika je konačna. 5.Izvršni načelnik ili lice koga je on ovlastio treba da radnika KAF-a koji se žalio obavesti pismeno o radniku koji je izricao meru i da obavesti kancelariju personala da donošenjem ove odluke da administrira istu u lični dosije radnika kao i u elektronskom sistemu podataka.
Neni 35 Ankesat për masat më të rënda 1. Punonjësi i AKF -së ndaj të cilit merret masë disiplinore, përvec masave të përcaktuara në neni 34 të këtij udhëzimi administrativ, ka të drejtë të ankohet me shkrim për masën e dhënë tek Komisioni i Ankesave brenda pesë (5) ditë pune nga	Article 35 Complaints for Serious Measures 1. Employee of KAF against whom is taken disciplinary measure, besides the measures set out in Article 34 of this Administrative Instruction; has the right to complaint in written form for the issued measure to the Complaints Committee	Član 35 Žalbe na teže mere 1.Radnici KAF-a prema kome se preduzima disciplinska mera, osim mera utvrđenim članom 34. ovog pravilnika, ima pravo da se žali pismeno o izricanoj meri kod Komisije za žalbe u roku od 5 radnih dana od momenta obaveštenja u pismenoj



çasti i njoftimit me shkrim për dhënien e masës. 2. Ankesa mund të dorëzohet pranë Zyrës së Personelit ose në njësinë ku ai punon, ku i vihet data e protokollimit. Punonjësi që kryen protokollimin e ankesës duhet t'i japë ankuesit një vërtetim për datën e regjistrimit të ankesës. Ankesa administrohet në Zyrën e Personelit e cila merr masat përkatëse për njoftimin e Komisionit të Ankesave. 3. Nëse ankesa nuk bëhet nga punonjësi brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, ajo nuk shqyrtohet dhe për këtë njoftohet punonjësi, eprori që ka dhënë masën, si dhe Zyra e Personelit.	within five working days from the moment of the written notice for the issued measure. 2. The complaint may be submitted to the office of personnel or in the unit where he works, where is put the date of protocol. The employee, who performs the protocol of complaint, must give to the person complaining a certificate for the registration date of the complaint. The complaint is administered in the personnel's office which takes the appropriate measures to inform the Commission of Appeals. 3. If the complaint is not done by the employee within the determinate time in paragraph 2 of this article, it is not reviewed and for that the employee, the supervisor who has issued the measure, and the personnel's office are notified.	formi o izrečenoj meri . 2. Žalba se dostavlja kancelariji personala ili jedinici gde on radi i u žalbi se stavlja datum zavođenja. Radnik koji radi na zavođenju žalbe, žaliocu daje potvrdu o datumu registrovanja žalbe. Žalba se administrira u kancelariji personala koja preduzima odgovarajuće mere za upoznavanje Komisije za žalbe. 3. Ako se žalba ne podnosi od strane radnika u utvrđenom roku u tački 2. ovog člana, žalba neće se razmotriti i o tome će radnik, staresina koji ja dao meru i kancelarija personala biti obavješteni.
Neni 36 Komisioni i Ankesave 1. Komisioni i Ankesave përbëhet nga 3 punonjës të AKF-së, të rangut të lartë, duke përjashtuar Kryeshefin Ekzekutiv në këto raste Kryeshefi Ekzekutiv cakton kryesues njërin nga eprorët e lartë të AKF -së. Ky komision shqyrton të gjitha ankesat për masat disiplinore. Pjesëtarët e këtij	Article 36 Complaints Commission 1. The Complaints Committee consists of three employees of the KAF, of high range, by excluding the Chief Executive; in these cases the Chief Executive appoints a chairman one of the high supervisors of KAF. This Committee reviews all complaints for the disciplinary measures.	Član 36 Žalbena komisija 1. Žalbena komisija se sastoji od 3. radnika KAF-a, isključujući Izvršnog načelnika. U ovim slučajevima Izvršni načelni određuje kao predsedavajućeg nekog od visokih starešina KAF-a. Oba komisija razmatra sve žalbe o disciplinskim merama. Članovi ove komisije određuju se



komisioni caktohen rast pas rasti me urdhër të Kryeshefit Ekzekutiv. Vendimet e Komisionit të Ankesave janë të formës së prerë dhe të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo punonjës. Këto vendime mund të atakohen nga palët vetëm në Gjykatë.	The members of this Committee are appointed case by case by order of the Chief Executive. The decisions by Complaints Committee are final and binding to be implemented by each employee. These decisions may be attacked by the parties in the court.	od slučaja do slučaja po naređenju Izvršnog načelnika. Odluke Žalbene komisije su konačne i obavezujuće da se sprovede od strane svakog radnika.
2. Punonjësi i AKF-së nuk mund të jetë anëtar i Komisionit të Ankesave në këto raste:	2. Employee of KAF could not be a member of the Commission of Complaints in these cases:	2. Radnik KAF-a ne može biti član Žalbene komisije u sledećim slučajevima:
2.1. kur ai është subjekt i procedurës disiplinore;	2.1. when it is the object of disciplinary procedure;	2.1. kada je on objekat disciplinske procedure;
2.2. kur ai është punonjësi që ka dhënë masën disiplinore që është atakuar;	2.2. when he is the employee who has issued the disciplinary measure which is attacked;	2.2. radnik koji je izrekao disciplinsku meru koja je osporena;
2.3. kur ai është vartës apo epror i drejtpërdrejtë i punonjësit që është ankuar;	2.3. when he is employee's immediate subordinate or superior which has complained;	2.3. kada je on neposredni potčinjeni ili starešina radnika koji se žalio;
2.4. kur është dëshmitar në ngjarje.	2.4. when is the witness in the case.	2.4. kada je svedok u događaju.
3. Punonjësi i AKF-së që ankohet ka të drejtë të kërkojë deri një herë ndryshimin e anëtarëve të Komisionit të Ankesave për arsyet e shprehura në paragrafin 2 të këtij neni.	3. Employee of KAF who complains has the right to seek to change once the members of the Complaints Committee for the reasons expressed in paragraph 2 of this article.	3. Radnik KAF-a koji se žalio ima pravo da jedan put traži izmenu članova Žalbene komisije zbog razloga navedenim u tašci 2. ovog člana.
4. Në rastet e përcaktuara në paragrafet 2	4. In the cases referred in paragraphs 2 and	4. U slučajevima utvrđenim u tačkama 2. i



dhe 3 të këtij neni, Kryeshefi Ekzekutiv e zëvendëson anëtarin e komisionit me një punonjës tjetër.	3 of this Article, the Chief Executive replaces the member of the Commission with another employee.	3. ovog člana , Izvršni načelnik zamenjuje člana Komisije sa drugim radnikom.
Neni 37 Ankesa ndaj Kryeshefit Ekzekutiv 1. Ankesa që bëhet ndaj Kryeshefit Ekzekutiv, dërgohet menjëherë tek Ministri i Punëve të Brendshme. 2. Në këtë rast, ministri përcakton procedurat dhe personat që do të merren me verifikimin dhe shqyrtimin e ankesës.	Article 37 The Complaint against the Executive Chief 1. The complaint which is done against the Chief Executive immediately will be send to the Minister of Internal Affairs. 2. In this case, the Minister shall establish the procedures and persons that will deal with the verification and reviewing of the complaint.	Član 37 Žalba protiv Izvršnog načelnika 1. Žalba koja se podnosi protiv Izvršnog načelnika, odmah se dostavlja Ministru unutrašnjih poslova. 2. U tom slučaju, Ministar utvrđuje procedure i lica koje će se baviti verifikacijom i razmatranjem žalbe.
Neni 38 Procedura e shqyrtimit të ankesës 1. Me marrjen e ankesës nga punonjësi i AKF-së, Komisioni i Ankesave administron, provat dhe faktet e shkruara në të cilat është mbështetur autoriteti përkatës për dhënien e masës. 2. Komisioni i Ankesave, kur e gjykon të nevojshme, mund të bëjë verifikime që lidhen me çështjen në shqyrtim. 3. Kryetari i Komisionit të Ankesave	Article 38 The Procedure for Reviewing the Complaint 1. When you get the complaint by employee of KAF, the Complaints Commission administers, evidences, and written facts in which is supported the relevant authority for issuing the measure. 2. The Complaints Commission when it deems necessary, it may make verifications that are related with the matter under the review. 3. The head of the Comission of	Član 38 Procedura razmatranja žalbe 1. Primanjem žalbe od strane radnika KAF-a, Komisija za žalbe administrira dokaze i pismene činjenice na kojima je baziran odgovarajući autoritet kada je izrekao meru. 2.Kada to vidi za shodno, Komisija za žalbe može da vrši verifikacije koje se nadovezuju sa pitanjem koja je u razmatranju. 3. Predsednik Komisije za žalbe pismeno



njofton me shkrim punonjësën e AKF-së për vendin, datën dhe orën e shqyrtimit të ankesës së tij, jo më vonë se pesë (5) ditë përpara datës së shqyrtimit. Gjithashtu, ai njofton anëtarët e komisionit për vendin, datën dhe orën e takimit, duke i vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës. 4. Punonjësi ka të drejtë të jetë i pranishëm dhe të mbrohet nga një punonjës mbrojtës tjetër i zgjedhur prej tij. Në këto raste punonjësit apo mbrojtësi i zgjedhur marrin pjesë në seancat e shqyrtimit të ankesës. 5. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioni i Ankesave mund të kërkojë praninë e punonjësve të tjerë të cilët kanë dijeni për ngjarjen apo shkeljen që pretendohet se ka kryer punonjësi. 6. Seancat e Komisionit të Ankesave për shqyrtimin e ankesave janë të hapura për punonjësit e AKF-së, me përjashtim të rasteve kur çështja që shqyrtohet përbën sekret. Në rastet kur masa disiplinore është dhënë si pasojë e ankesës së ardhur nga qytetarët apo institucionet, seancat e komisionit mund të jenë të hapura edhe për mediat dhe publikun, kur ato nuk përbëjnë sekret. Vendimin për pjesëmarrjen e personave të tjerë në seancë e merr	Complaints shall notify in written form the employee of KAF for the place, date and time of the review of his complaint, not later than five days before the date of review. Also, he reports the members of the Committee for the place, date and time of the meeting, by making available relevant documentation. 4. The employee has the right to be present and to be protected by another employee defender selected by him. In these cases employees or the selected defenders take part in the review of complaint hearings. 5. During the review of the complaint, the Complaints Commission may request the presence of the other employees who have knowledge for the incident or the breach that is alleged that employee has committed. 6. Proceedings of the Complaints Commission for reviewing complaints are open to employees of KAF, except cases when the matter which is reviewed is considered confidential. In cases when the disciplinary measure is issued as a consequence of the complaint that came by citizens or institutions, the Commission's sessions may be open also for public media, when they are not secret. The decision for taking part in hearing for other	obaveštava radnika KAF-a o mestu, datuma i vreme razmatranje njegove žalbe, najkasnije 5 dana pre datuma razmatranja. On isto tako obaveštava članove Komisije o mestu, datuma i vremenu susreta stavljajući im na raspolaganje odgovarajuću dokumentaciju. 4. Radnik ima pravo da bude prisutan i da se brani od strane radnika, drugi branilac izabran od njega. U tim slučajevima radnik ili izabrani branilac učestvuje na sednicama razmatranja žalbe. 5. Tokom razmatranja žalbe, Komisija za žalbe može tražiti prisustvo drugih radnika koji imaju saznanja o događaju ili o prekršaju koji se pretendira da je izvršio radnik. 6. Sednice Komisije za razmatranje žalbi su otvorene za radnika KAF-a, osim slučajeva kada pitanje koja se razmatra čini tajnu. U slučaju kada disciplinska mera je izrečena kao posledica žalbi koje su došle od strane građana ili institucija, sednice Komisija mogu biti otvorene za medije i javnost kada to ne čini tajnu. Odluku o učestvovanju drugih lica na sednici donosi komisija. Protiv odluke za odbijanje učestvovanja na sednici drugih
--	--	--



komisioni. Kundër vendimit për moslejimin e pjesëmarrjes në seancë të personave tjerë nuk lejohet ankesë.	persons makes the commission. Against the decision for not allowing the participation in the hearing of the other persons complaint is not allowed.	lica, nije dozvoljena žalba.
7. Seancat e shqyrtimit të ankesës së punonjësit pasqyrohen në procesverbalin përkatës të Komisionit të Ankesave.	7. The hearing of the review of the employee's complaint is reflected in the relevant records of the Commission of Complaints.	7. Na sednici za razmatranja žalbe radnika vodi se odgovarajući zapisnik Komisije za žalbe.
8. Vendimi i Komisionit të Ankesave duhet të jetë i arsyetuar dhe i bazuar në prova, fakte të shkruara si dhe në aktet normative në fuqi. Ai merret me shumicë votash dhe pa praninë e personave të tjerë.	8. Complaint Commission decision must be justified and based on evidence, written facts and in normative acts in force. It deals with the majority votes and without the presence of the other persons.	8.Odluka Komisije za žalbe treba da bude obrazložen i zasnovan na dokazima, pisane činjenice kao i na normativnim aktima koji su na snazi. Odluka se donosi većinom glasova bez prisustva drugih lica.
9. Komisioni i Ankesave i komunikon me shkrim punonjësit vendimin, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se pesë (5) ditë pune, duke i dhënë një kopje të vendimit si dhe fotokopje të dokumentacionit të shqyrtuar. Për vendimin e marrë njoftohet me shkrim edhe autoriteti që ka dhënë masën disiplinore.	9. Complaints Commission communicates the decision to employee in written form, as soon as possible, but not later than five working days, by providing a copy of decision and a photocopy of the reviewed documentation. For the decision made is notified in a written form also the authority who issued the disciplinary measure.	9. Komisija za žalbe saopštava radniku pisanu odluku što je moguće pre ali ne kasnije od 5 radnih dana i njemu daje jednu kopiju odluke i fotokopiju razmotrene dokumentacije. O donetoj odluci obaveštava se u pismenoj formi i autoritet koji je izrekao disciplinsku meru.
10. Komisioni i Ankesave duhet të përfundojë shqyrtimin e ankesës dhe të marrë vendim jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga momenti i marrjes së ankesës. Në raste të veçanta, ky afat mund të shtyhet për dy herë nga tridhjetë (30) ditë të tjera me vendim të arsyetuar të Komisionit të	10. The Complaints Commission shall finish the review of the complaint and make a decision not later than 60 days from the moment of receiving the complaint. In special cases, this deadline might be postponed twice by 30 days to justify the decision of the Complaints	10.Komisija za žalbe trba da okončava razmatranje žalbe i da donosi odluku najkasnije do 60. dana od momenta dobijanja žalbe. U posebnim slučajevima ovaj rok može da se odlaže dva puta po 30 drugih dana no osnovu obrazložene odluke Komisije za žalbe.



Ankesave. 11. Në rast se punonjësi i AKF-së nuk paraqitet në seancën e caktuar për shqyrtimin e ankesës së tij, për shkaqe të arsyeshme, seanca mund të shtyhet jo më shumë se një herë. Mosparaqitja pa shkaqe të arsyeshme e punonjësit të këtij shërbimi nuk e pengon shqyrtimin e çështjes. Neni 39 Procedura e shqyrtimit të ankesës për punonjësin e AKF -së me masë sigurie Për punonjësin e AKF-së që është me masë sigurie “arrest në shtëpi”, “paraburgim” procedurat e shqyrtimit të ankesës janë të njëjta sipas përcaktimeve të nenit 38 të këtij udhëzimi administrativ. Në këto raste, komisioni i cakton si mbrojtës një punonjës të AKF-së mundësisht me gradë ose detyrë më të lartë se ajo që ai mban. Neni 40 Përgatitja dhe administrimi i dokumentacionit Ankesa për masat disiplinore, si dhe i gjithë dokumentacioni që ka lidhje me	Committee. 11. If the employee of KAF doesn't appear in the appointed hearing for reviewing his complaint, for justifying causes, the hearing might be postponed no more than once. Nonappearance of the employee for this service without reasonable causes does not prevent the review of the case. Article 39 The Procedure for Reviewing Complaint for Employee of KFA with Security Measure For employee of KAF which is with security measure that is "home arrest", "custody" the procedures of reviewing the complaint are the same according to the provisions of Article 38 of this Administrative Instruction. In these cases, the commission appoints as defender an employee of KAF preferably with a higher rank or duty which he holds Article 40 Preparation and Administration of Documentation Complaint about the disciplinary measures, and all the documentation related to review	11.Ako se radnik KAF-a ne javlja na određenu sednicu za razmatranje njegove žalbe zbog opravdanih razloga, sednica može se odložiti samo jedan put. Ne prijavljivanje zbog neopravdanih razloga radnika ove službe, ne odlaže razmatranje pitanja. Član 39 Procedura razmatranja žalbe za radnika KAF-a po sigurnosnom merom Za radnika KAF-a koji je pod merom sigurnosti „Kućni pritvor“ ili „pritvor“ procedura razmatranja žalbe su iste prema utvrđenju člana 38. ovog Pravilnika. U tim slučajevima Komisija određuje kao branilac nekog radnika KAF-a po mogućnosti sa višim činom ili službom u odnosu na radnika. Član 40 Priprema i administriranje dokumentacije Žalbe o disciplinskim merama kao i čitava dokumentacija koja se odnosi na
--	---	--



shqyrtimin e çështjes nga Komisioni i Ankesave, që nga njoftimi i punonjësit për shqyrtimin e ankesës deri në dhënien e vendimit të komisionit, përgatiten dhe administrohen nga Zyra e Personelit. Kjo zyrë ka detyrimin t'u sigurojë palëve, me kërkesën e tyre, kopje të dokumentacionit që ka lidhje me çështjen në shqyrtim.	of the case by the Commission of Complaints, since the announcement of the employee to review the complaint till issuing the Commission's decision, are prepared and administered by the personnel's office. This office has the obligation to provide to the parties, upon their request, the copies of documentation related to the issue under review.	razmatranje pitanja od strane Žalbene komisije, od samog obaveštenja radnika o razmatranju žalbe do donošenja odluke Komisije , pripremaju se administriraju od kancelarije personala. Ova kancelarija je obavezna da strankama na njihov zahtev obezbedi kopiju dokumentacije koja se odnosi na pitanje koja se razmatra.
KREU VIII ADMINISTRIMI I MASAVE DHE DISPOZITA KALIMTARE	CHAPTER VIII ADMINISTRATION OF MEASURES AND TRANSITIONAL PROVISIONS	POGLAVLE VIII ADMINISTRIRANJE PRELAZNIH MERA I ODREDABA
Neni 41 Ekzekutimi dhe administrimi i masës disiplinore	Article 41 The Execution and Administration of the Disciplinary Measure	Član 41 Izvršenje i administriranje disciplinske mere
1. Masa disiplinore e dhënë ndaj punonjësit të AKF-së që nuk atakohet brenda afateve të përcaktuara në nenin 34 dhe 35 të ketij udhëzimi administrativ, ekzekutohet dhe vendoset në dosjen personale të punonjësit si dhe regjistrohet në sistemin e të dhënave nga Zyra e Personelit. 2. Masa disiplinore, për të cilën është bërë ankesa nga punonjësi, ekzekutohet dhe vendoset në dosjen personale të tij si dhe regjistrohet në sistemin e të dhënave nga	1. The issued disciplinary measure against employee of the KAF who is not attacked within the limits specified in Article 34 and 35 of this administrative instruction, is executed and placed in the employee's personal file and is recorded in the data system by the office of the personnel. 2. The disciplinary measure, for which is done a complaint from employee, is executed and placed in his personal file and is recorded in the data system of the office	1. Disciplinska mera izrečena protiv radnika KAF-a koja se ne osporava u predviđenim rokovima članom 34. i 35. ovog pravilnika, izvršava se i postavlja u lični dosije radnika i registruje se u sistemu podataka od strane personala. 2. Disciplinska mera protiv koje je podneta žalba od strane radnika, izvršava se i postavlja u njegov personalni dosije i registruje se u sistemu podataka od strane



Zyra e Personelit, pasi të jetë marrë vendimi përfundimtar nga titullari ose Komisioni i Ankesave. 3. Në çdo rast, masa disiplinore ekzekutohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga komunikimi i saj ose nga marrja e vendimit nga eprori apo Komisioni i Ankesave. 4. Efektet e masës disiplinore fillojnë pasi të ketë përfunduar afati i ankesës dhe punonjësi nuk është ankuar, ose pasi të jetë dhënë vendimi i Eprorit apo i Komisionit të Ankesave. 5. Kur punonjësi është ndëshkuar me masën disiplinore “largim nga puna”, Komisioni i Ankesave i dërgon Zyrës së Personelit një kopje të vendimit. Nëse vendimi i Komisionit të Ankesave lë në fuqi masën e dhënë nga eprori, Zyra e Personelit përgatit urdhrin e përjashtimit dhe ndërprerjes së marrëdhënieve financiare të punonjësit. 6. Nëse gjatë shqyrtimit në Komisionin e Ankesave rezultojnë se nuk janë respektuar procedurat e ekzistues disiplinore të përcaktuara në këtë udhëzim administrativ, duke filluar nga njoftimi me shkrim për fillimin e procedurës disiplinore ndaj tij,	of the personnel, after the final decision taken by the holder or the Complaints Committee. 3. In any case, the disciplinary measure is executed within 30 days from its communication or decision made by the Supervisor or Complaints Committee. 4. The effects of a disciplinary measure begin after the final term of complaint has finished and employee did not complaint, or after is issued the decision of the supervisor or of the Complaints Commission. 5. When the employee is punished with the disciplinary measure "dismissal from job", the Complaints Commission's sends a copy of decision to the office of the personnel. If the Complaints Commission decision leaves in force the issued measure from the supervisor, the office of personnel prepares the command for dismissal and cessation of employee's financial relationship. 6. If during the review at Complaints Commission results that were not respected the disciplinary performance procedures defined in this administrative instruction, starting from the written notification for the beginning of the disciplinary procedure	kancelarije personala nakon donošene konačne odluke od strane titulara ili Žalbene komisije. 3. U svim slučajevima disciplinska mera se izvršava u roku od 30 dana od dana saopštenja iste ili od donošenja odluke od strane staresine ili Žalbene komisije. 4. Efekti disciplinske mere počinju nakon okončanja žalbenog roka i radnik nije se žalio ili nakon donošenja odluke od strane staresine ili Žalbene komisije. 5. kada je radnik kažnjen disciplinskom merom „isključenja sa posla“, Komisija za žalbe dostavlja kancelariji personala kopiju odluke. Ako odluka Komisije za žalbe ostavlja na snagu izrečenu meru od strane staresine, kancelarija personala priprema naredbu o isključenju i prestanka finansijskih odnosa radnika. 6. Ako tokom razmatranja u Komisija za žalbe rezultira da nisu poštovane disciplinske procedure utvrđenim ovim administrativnim uputstvom, počevši od pismenog obaveštenje o početku disciplinske procedure protiv njega,
---	---	--



masa disiplinore e dhënë ndaj tij anulohet automatikisht dhe njëkohësisht mund t'i rikthehet titullarit për arsyet e mësipërme. 7. Zyra e Personelit evidenton të gjitha ankesat dhe shkeljet disiplinore. 8. Në rastet e masave jodisiplinore, argumentimi për mosdhënien e masës evidentohet në regjistrin e Zyrës së Personelit.	against him, the disciplinary measure issued against him is automatically annulled and at the same time may be returned to the holder because of the aforementioned reasons. 7. The office of personnel records all the complaints and disciplinary breaches. 8. In the cases of non disciplinary measures, the argumentation for not issuing the measure is recorded in the register of personnel's office.	disciplinska mera izrečena protiv njega automatski se anulira a istovremeno se vraća titularu zbog gore navedenih razloga. 7. Kancelarija personala evidentira sve žalbe i disciplinske prekršaje. 8. U slučajevima ne disciplinskih mera, argument o ne izricanju mere, evidentira se u registru kancelarije personala.
Neni 42 Praktikat shkresore Praktikat shkresore si dhe forma konkrete e hartimit të dokumenteve të përcaktuara në këtë udhëzim administrativ janë të unifikuara. Ato përgatiten nga Zyra e Personelit dhe miratohen nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së.	Article 42 Written Practices The written practices and the concrete form of drafting the documents specified in this Administrative Instruction are unified. They are prepared by the office of the personnel and are approved by the Chief Executive of KAF.	Član 42 Prakse u vezi spisa Prakse spisa kao konkretna forma izrade dokumenata utvrđenim ovim pravilnikom su jedinstvene. Ove materijale priprema kancelarija personala i usvaja ih Izvršni načelnik KAF-a.
Neni 43 Hyrja në fuqi Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi pas nënshkrimit të Ministrit të Punëve të Brendshme.	Article 43 Entry into force This Administrative Instruction enters into force when signed by the Minister of the Ministry of Internal Affairs.	Član 43 Stupanje na snagu Ovo Administrativno naređenje stupa na snagu nakon potpisivanja Ministra Unutrašnjih Poslova.



Ministria e Punëve të Brendshme <u>Bexhepi</u> Bajram Rexhepi, Ministër Prishtinë, Date: <u>27</u> / <u>09</u> / <u>2012</u>	Ministry of Internal Affairs <u>Bexhepi</u> Bajram Rexhepi, Minister Pristina, Date: <u>27</u> / <u>09</u> / <u>2012</u>	Ministarstvo Unutrašnjih Poslova <u>Bexhepi</u> Bajram Rexhepi, Ministar Priština, Datum: <u>27</u> / <u>09</u> / <u>2012</u>
---	---	--